

**“ALBAN.DEL” sh.p.k**

Selia: Rruga Abdi Toptani, Torre Drini, Kati i dytë,  
Tirana – Albania

**Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2019**

( me raportin e audituesit të pavarur ne vazhdim)

Tirane, 2 Mars 2020

**“ALBAN.DEL” sh.p.k**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET*

---

**Përmbajtja**

1. Opinioni i Audituesit të Pavarur
2. Pasqyra e Situatës Financiare
3. Pasqyra e performancës
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshmeve në kapital
6. Shënime shpjeguese

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për Ortakut të Shoqërisë  
“ALBAN.DEL” Shpk  
Kapitali i regjistruar ne QKB-ne prej 97.338,400 leke  
Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2  
Tiranë - Shqipëri**

### Opinionit

Une kam audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare “**ALBAN.DEL**”sh.p.k.,(shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur me datën 31 Dhjetor 2019, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë tregtare “**ALBAN.DEL**”sh.p.k.,me datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar (SNK/SNRF).

### Baza për Opinionin

Une e kreja auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë e mia sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Une jam e pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kam përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Une besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Organeve të Qeverisjes per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar (SNK/SNRF),dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Drejtimi ka gjithashtu, përgjegjësinë për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar veprimtarite në vijimësi, duke dhënë per kete qellim, kur eshte rasti, informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë nisur nga parimi kontabël i vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likujdojë shoqërinë, të ndërpresë aktivitetet e saj, ose rasteve kur drejtimi nuk ka alternativë tjetër reale përveç likujdimit te shoqerise.

Organet e ngarkuara me qeverisjen kane përgjegjësinë për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat e mia te auditimit janë: të arrijmë një siguri të arsyeshme per faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e audituesit. Siguria e arsyeshme megjithese është një



**“ALBAN.DEL” sh.p.k**  
**PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET*

siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.


Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Nje auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kërkon qe ne si auditues te ushtrojmë gjykimin profesional dhe te ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Une gjithashtu:

- Identifikoj dhe vlerësoj rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i anomalisë materiale si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara ose anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Siguroj një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- Vlerësoj përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerr një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Kur arrij në përfundimin që ka një pasiguri une duhet të tërheq vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikoj opinionin tim. Konkluzionet e mia bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tim të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Une komunikoj me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që une mund të identifikoj gjatë auditimit.

**Audituesi ligjor**

**EDA ABAZI, (AL/CPA)**  
**Partner Auditimi**  
**Studio L.E.A.L Auditing shpk**  
**Rruga e Barrikadave Ish Kinema 17 Nentori,**  
**Tel: +355 42 227 695**  
**Fax: +355 42 227 695**



**10 Mars 2020**

**“ALBAN.DEL” sh.p.k**  
**PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

**Pasqyra e situatës financiare e datës 31 dhjetor 2019**

<b>AKTIVET</b>	Shënim	31.12.2019	31.12.2018
<b>Aktivitet Afatshkurtra</b>			
Aktive monetare	4	27,930,080	4,762,077
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	88,412,909	90,082,191
Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	6	45,701,613	97,397,886
<b>Totali 3</b>		<b>134,114,522</b>	<b>187,480,077</b>
<b>Inventari</b>			
Lëndët e para	7	18,475,205	23,205,338
Prodhim në proces	7	15,704,392	6,064,262
Produkte të gatshme	7	26,062,257	16,617,607
<b>Totali 4</b>		<b>60,241,853</b>	<b>45,887,208</b>
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	8	8,676,249	29,820,306
<b>Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)</b>		<b>230,962,705</b>	<b>267,949,668</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale			
Makineri dhe pajisje	9	76,342,661	97,068,807
Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	9	91,314,629	79,011,578
E drejta për përdorimin e aktiveve	9	81,546,850	-
<b>Totali 2</b>		<b>249,204,140</b>	<b>176,080,385</b>
Aktive tatimore të shtyra	10	15,042,003	17,460,932
<b>Totali i aktiveve Afatgjata (II)</b>		<b>264,246,143</b>	<b>193,541,317</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE (I + II)</b>		<b>495,208,848</b>	<b>461,490,986</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>DETYRIMET Afatshkurtëra</b>			
Detyrime për qira	11.a	19,040,328	-
Huat dhe parapagimet			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	11.b	60,309,931	110,775,306
Të pagueshme ndaj punonjësve	12	9,703,338	645,877
Detyrime tatimore	13	5,918,777	5,345,522
<b>Totali I Huave dhe afatshkurtra</b>		<b>75,932,046</b>	<b>116,766,706</b>
<b>Totali i detyr. afatshkurtra (I)</b>		<b>94,972,374</b>	<b>116,766,706</b>
<b>DETYRIME AFATGJATA</b>			
Huat afatgjata			
Detyrime nga qirate	14	47,719,708	2,059,019
<b>Totali 1</b>		<b>47,719,708</b>	<b>2,059,019</b>
Huamarrje të tjera afatgjata	15	156,351,852	159,211,800
Tatim i shtyrë	10	-	-
<b>Totali i detyr. afatgjata (II)</b>		<b>204,071,560</b>	<b>161,270,819</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>299,043,934</b>	<b>278,037,525</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	16	97,338,400	97,338,400
Rezerva ligjore		8,398,298	8,398,298
Fitimet e pashpërndara	16	77,716,763	120,226,032
Fitimi (humbja) e vitit financiar	16	12,711,453	-42,509,269
<b>Totali i kapitalit (III)</b>		<b>196,164,914</b>	<b>183,453,461</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT</b>		<b>495,208,848</b>	<b>461,490,986</b>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-27

**“ALBAN.DEL” sh.p.k**  
**PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDQI ME**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

**Pasqyra e të Ardhurave Gjithë përfshirëse për periudhën që përfundon më 31.12.2019**

		Viti 2019	Viti 2018
Shitjet neto	17.1	702,747,514	620,996,595
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	17.2	1,209,832	153,834
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimin në proces	18	19,084,779	67,930
Materialet e konsumuara .	19	-83,721,480	-75,817,066
Kosto e punës	20	<b>-190,153,237</b>	<b>196,505,223</b>
-Pagat e personelit	20	-165,585,682	-171,091,401
-Të tjera personeli	20	0	-91,121
-Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetësore	20	-24,567,555	-25,322,701
Amortizimi dhe zhvleresimet	9,21	-89,515,661	-53,538,331
Shpenzime të tjera	22	-338,742,772	-340,571,534
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>-702,133,151</b>	<b>-666,432,154</b>
<b>Fitmi apo humbja nga veprimtaria kryesore</b>		<b>20,908,974</b>	<b>-45,213,795</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	23	-4,785,162	-1,932,984
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	24	-993,430	-2,692,500
Shpenzime të tjera financiare		-	-
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>-5,778,592</b>	<b>-4,625,484</b>
<b>Fitimi (humbja) para tatimit</b>	25	<b>15,130,382</b>	<b>-49,839,278</b>
<b>Shpenzimet e tatimit mbi fitimin</b>		<b>2,418,929</b>	<b>-7,330,009</b>
Shpenzim aktual e tatimit mbi fitimin	25,10	-	-
Shpenzimi i shtyre i tatimit mbi fitimin	25,10	2,418,929	-7,330,009
<b>Fitmi (humbja) neto e vitit financiar</b>		<b>12,711,453</b>	<b>-42,509,269</b>
<b>Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse</b>		-	-
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM		-	-
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAFinanciare		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet</b>		-	-
<b>Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën</b>		<b>12,711,453</b>	<b>-42,509,269</b>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-27

**“ALBAN.DEL” sh.p.k**

**PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET*

**Pasqyra e ndryshimit të flukseve te mjeteve monetare për periudhën që përfundon më  
31.12.2019**

	Shen	2019	2018
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
<b>Fitimimi para tatimit</b>	25	12,711,453	-42,509,269
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime te llogaritura	12	-1,093,315	-24,082
Amortizimi i Aktive Afatgjata	9	89,515,661	53,538,331
Diferenca kursi kembimi furnitore & Klient	5,12	-2,334,852	-7,862,400
		<b>98,798,948</b>	<b>3,142,580</b>
Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	4,997,564	-33,480,219
Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme te tjera	6	51,696,273	-51,901,124
Rritje/rënie në tepricën inventarit	7	-14,354,646	-2,542,156
Rritje/rënie në Shpenzimet e Shtyra	8	21,144,057	6,698,626
Rritje/rënie në tepricën e Llogarive te Pagueshme ( Furnitoreve)	12	-49,372,061	50,036,894
Rritje/Rënie në detyrimet ndaj punonjësve	13	9,057,461	-11,017,373
Rritje/rënie në tepricën e Detyrimeve tatimore	14	573,255	-284,316
Rritje/Rënie në tepricën e huarave të tjera	15	-	-
Rritje/rënie në Aktivet tatimore të shtyra	10	2,418,929	-7,330,009
		<b>26,160,832</b>	<b>-49,819,677</b>
		<b>124,959,780</b>	<b>-46,677,096</b>
<b><u>MM Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</u></b>			
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</b>			
Pagesa per Blerja e aktiveve afatgjata	9	-163,799,094	-61,245,735
Arketime nga shitja/nxjerrja Jashte perdorimit e aktiveve afatgjata materiale	9	1,159,677	2,223,479
		<b>-162,639,417</b>	<b>-59,022,256</b>
<b><u>MM neto, e përdorur në aktivitetet investuese</u></b>			
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare</b>			
Rritje/Pakesime detyrimeve të qirasë financiare		64,701,018	2,059,019
Rritje/pakesime huamarrje afatgjata	11	-2,859,948	92,736,800
		<b>61,841,070</b>	<b>94,795,819</b>
<b><u>MM neto e përdorur në aktivitetet financiare</u></b>			
Diferenca Konvertimi te MM te mbajtura ne Monedhe te Huaj	23	-993,430	-2,692,500
		<b>23,168,003</b>	<b>-13,596,033</b>
<b>Rritja/rënia neto e mjeteve monetare</b>			
		<b>4,762,077</b>	<b>18,358,110</b>
<b>Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël</b>			
		<b>27,930,080</b>	<b>4,762,077</b>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-27

**Alban.Del shpk**  
**PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHIKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar për periudhën janar- dhjetor 2019

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitimi i Pashpërndarë	Totali
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2017</b>	<b>97,338,400</b>	<b>8,398,298</b>	<b>120,226,032</b>	<b>225,962,730</b>
Kapitali aksionar				-
Emetim i kapitalit aksionar				-
Rezerva ligjore				-
Fitimi (humbja) neto e periudhave te kaluara				-
Fitimi (humbja) neto i periudhës			-42,509,269	-42,509,269
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2018</b>	<b>97,338,400</b>	<b>8,398,298</b>	<b>77,716,763</b>	<b>183,453,461</b>
Kapitali aksionar				-
Emetim i kapitalit aksionar				-
Rezerva ligjore				-
Fitimi (humbja) neto e periudhave te kaluara				-
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël			12,711,453	12,711,453
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2019</b>	<b>97,338,400</b>	<b>8,398,298</b>	<b>90,428,216</b>	<b>196,164,914</b>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-27

Pasqyrat Financiare “Alban.Del” Shpk janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë  
 Më datë 10 Mars 2020

**Kontabilisti i Miratuar**  
 TIRANA  
 ALBANIA  
 SHPK  
 Sotiraq Dhamo

**Administratori**  
  
 Umberto Macchi Di Cellere

**ALBAN.DEL SH.P.K.**  
 NIPT K91825012J  
 Rruga: Abdi Toptani,  
 Torre Drin, Kati II, Tiranë



## Alban.Del shpk

PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

### 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Alban Del shpk, në vijim e quajtur "Shoqëria", është themeluar sipas aktit të themelimit më datën 03.06.2009 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datën 25.06.2009. Në momentin e themelimit ortak i vetëm i kapitalit prej 2,614 mije lekësh ishte shoqëria TODS INTERNATIONAL BV, shoqëri e së drejtës Hollandese me seli ne Amsterdam, P.Cornelisz Hooftsr 74, 1071 CB.

Alban Del është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali është ndare në 7,200 pjesë me vlerën nominale prej 13,519.22 lekë secila.

Shoqëria është regjistruar si person juridik në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tiranës me NIPT K91825012J

Më 31 Dhjetor 2019 shoqëria ka 299 punonjës (31 dhjetor 2018, 318).

Aktiviteti i saj kryesor i shoqërisë, është prodhimi me material të porositesit të pjesëve të sipërme të këpuceve. Shoqëria ka një kontratë porosie me një klient për prodhimin e faqeve të sipërme prej lëkure të këpuceve.

Aktiviteti kryhet në Shkozet –Durrës.

Në datën e këtyre PF struktura e zotimit të kapitalit paraqitet si vijon:

Emri i ortakut	Numri i pjesëve	% e kapitalit
TODS INTERNATIONAL BV	7,200	100
<b>Totali</b>	<b>7,200</b>	<b>100</b>

Administratori ligjor i shoqërisë është z. Umberto Macchi Di Cellere i cili ka caktuar me prokurë të posaçme si përfaqësuese të tij znj. Aurela Bakushi.

Adresa e Selisë ligjore të Shoqërisë është : Rr. Abdi Toptani, Torre Drini, kati i 2, Tiranë,

### 2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

Shoqëria zbaton SNRF për përgatitjen dhe prezantimin e Pasqyrave Financiare për periudhën ushtrimore që përfundon në 31 dhjetor 2019 pasi plotëson kërkesat e prashikuara nga ligji Nr.25-2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" për këto standarde. Ato përfshijnë standartet e aprovuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standarteve të Kontabilitetit (BNSK) dhe interpretimet e standarteve të botuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Standarteve të Raportimit Financiar (KNISRF) ose ish Komiteti i Përhershëm i Interpretimeve dhe që janë publikuar nga KKK dhe janë në fuqi në vitin 2019.

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25-2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK/SNRF) në fuqi në këtë datë dhe të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në gjuhën Shqipe.

**Alban.Del shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGJUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

**(a) Parimet e përgatitjes**

Pasqyrat financiare përgatiten duke u bazuar në koston historike, me përjashtim të disa kategorive të aktiveve dhe detyrimeve, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar që janë në fuqi në vitin 2019.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që të përdoren disa vlerësime kontabël të rëndësishme. Gjithashtu kërkohet që Drejtimi të ushtrojë gjykimin e vet përsa i përket politikave kontabël që aplikohen në shoqëri.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SNRF-ve në fuqi dhe të ligjit nr. 25-2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe paraqiten në shënimin vijues.

**3. Politikat kontabël kryesore**

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane përgatitur pasqyrat financiare jane paraqitur sa me poshte:

**3.1 Transaksionet me monedhat e huaja**

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) *Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ( “monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

ii) *Transaksionet dhe tepricat*

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “Të tjera të ardhura/shpenzime” për diferencat e lidhura me kërkesat për t’u arkëtuar dhe detyrimet ndaj furnitorëve, dhe në zërin “Fitime/humbje nga këmbimi” në rastin e mjeteve monetare.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2019 janë:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Euro	121.77	123.42

**3.2 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM ne dore dhe ato te mbajtura ne banka. Në përputhje me SNK 7 “Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare”, Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat)

### 3.2 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare -Vazhdim

dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak). Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

### 3.3 Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientët dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi për ulje vlere nëse ka. Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer.

Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësise për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është e evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të bilancit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient apo debitor dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma. Shuma e zhvlerësimit nga ulja e vlerës është diferenca midis vlerës neto kontabël të aktivitetit dhe vlerës neto aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar, të diskontuara me normën e interesit efektive.

Një aktiv financiar sipas përkufizimit të SNK 32 "Instrumentet financiare: Shënimet shpjeguese dhe Paraqitja" ç' regjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

### 3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SNK 2 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të indentifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të voglën midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja matet me metodën FiFo. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuara të shitjes apo të përfundimit të prodhimit. Çmuarjet e vlerës neto të realizueshme bazohen në evidencën më të besueshme që ekziston, në kohën kur bëhen këto vlerësime, për shumën e inventarëve që pritet të realizohet. Çmuarjet e vlerës neto të realizueshme marrin në konsideratë edhe qëllimin për të cilin mbahet inventari. Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit periodik dhe metodën e koston FiFo për matjen e inventarëve gjendje. Në datën e ndërtimit të PF shoqëria ka gjykuar që kosto e inventarit është më e ulët se vlera neto e realizueshme prandaj janë paraqitur të vlerësuara me koston FiFo të tyre.

#### a) *Kosto e Prodhimit të gatshëm dhe prodhimit në proces*

Kosto e prodhimit të gatshëm dhe prodhimit në proces përfshin koston direkte të lidhura që identifikohen për sasinë e prodhuar si psh: kosto e punës së dorës, kosto e materialeve etj. Gjithashtu ato përfshijnë dhe shpenzimet e përgjithshme të prodhimit direkte dhe indirekte që lidhen me procesin e prodhimit. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit indirekte janë ato shpenzime të cilat mbesin konstante gjatë prodhimit pavarësisht sasië së prodhuar, si psh, qeraja e fabrikës dhe administrimit të saj, shpenzimet e amortizimit etj. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit direkte janë ato shpenzime të prodhimit të cilat variojnë nga sasia e prodhuar si të tilla permendim: koston e materialeve ndihmëse dhe koston e punës indirekte. Shpërndarja e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit kryhet bazuar në peshën specifike mesatare të çdo komponenti mbi totalin e sasive të prodhuara. Shpenzimet indirekte të pashpërndara janë njohur si shpenzime të periudhës në të cilën ato kanë ndodhur.

### 3.5 Aktivet e Afatgjata Materiale dhe Jomateriale (AAM dhe AAJM)

#### (i) *Njohja dhe vlerësimi*

Në grupin e AAM fillimisht njihen vetëm ato elemente për të cilat kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme dhe pritet të sjellin përfitime ekonomike në të ardhmen për shoqërinë. AAM vlerësohen në hyrje me koston historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

## Alban.Del shpk

### PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

#### (ii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale llogaritet dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas kërkesave të SNK/SNRF duke synuar një bazë të përshtatshme të shpërndarjes së kostos së AAM. Shoqëria llogarit amortizimin e AAM dhe te AAJM dhe e njih në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare me norma të cilat janë të përafërta me jetëgjatësinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit të përdorura në ndërtimin e PF janë të paraqitura si më poshtë:

	<i>Norma Amortizimit</i>	<i>Metoda Llogaritjes</i>
	%	
Rikonstruksione ndërtese	25%	Metoda lineare
Makineri pune	12.5%	Metoda lineare
Paisje të fabrikës	20%	Metoda lineare
Paisje Informatike	25%	Metoda lineare
Mobilje dhe Orendi	12%	Metoda lineare
Aktive me vlerë të vogël	25%	Metoda lineare

#### 3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

#### 3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtëra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe në detyrime të tjera.

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv.

## **Alban.Del shpk**

PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

### **3.7 Detyrimet-Vazhdim**

Shoqëria i paraqet detyrimet për qiratë, e kontabilizuara sipas SNRF 16 "Qiratë" në Detyrime afatshkurtëra, ku paraqet shumën e detyrimit të qirave që pritet të shlyhen në periudhën pasadhëse, dhe në detyrime afatgjata qiraje, që paraqesin shumën e detyrimit të qirave që do të shlyhen pas më shumë se 12 muaj nga data e ndërtimit të këtyre PF. Në përputhje me SNRF 16 shoqëria vlerëson detyrimin e qirave si qiramarrës, me vlerën aktuale të fluksit të ardhshëm të pagasave lidhur me këto qira.

### **3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet**

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë aktivitetin kryesor të shoqërisë, neto nga TVSH. Ato njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së produktit/shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëhere kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

### **3.9 Përfitimet e personelit**

*(i) Kontributet per sigurime shoqerore dhe te ngjashme*

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Shoqëria, paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të cilat bëjnë të mundur përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për të përcaktuar vlerën minimale për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore për qëllime të pensionit duke u bazuar në një skemë të pensioneve me kontribut të përcaktuar. Kontributet e shoqërisë në skemën e përfimit të pensionit regjistrohen si shpenzime kur ato përlllogariten.

*(ii) Leje e zakonshme e paguar*

Shoqëria i njeh si një shpenzim personeli dhe si detyrime ato kosto që lidhen me lejen e zakonshme që u takon punonjësve për periudhën kur në fakt merret leja e zakonshme prej tyre.

### **3.10 Provizionet**

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të behet një vlerësim relativisht i saktë i shumës së detyrimit. Provizionet njihen në datën e ndërtimit të bilancit për vlerën e tashme të shpenzimeve që kërkohen për përcaktimin e detyrimit duke përdorur flukse të ardhshme të parasë të rregulluara me riskun. Shumat e periudhave të ardhshme skontohe duke përdorur normen e skontimit. Provizionet përcaktohen në mënyrë të pavarur nga vlera e përfitimeve nga sigurimi përkatës. Shoqëria nuk ka njohur provizion për vitin 2019.

### 3.11 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria zbaton kërkesat e SNK 12 për tatimin aktual mbi fitimin dhe tatimin e shtyrë mbi fitimin. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohjura sipas përcaktimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat". Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon të paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

Shoqëria llogarit aktivet apo detyrimet tatimore të shtyra dhe i paraqet në pasqyrat financiare bazuar në materialitetit e tyre. Ajo përdor normën e tatimit mbi fitimin që parashikohet të jetë në fuqi në periudhën pasardhëse.

Aktiv tatimor i shtyrë janë shumat e tatimit mbi fitimin të rikuperushme në periudhat e ardhshme, dhe që lindin nga diferencat e përkohshme të zbritshme, të cilat në periudhat e ardhme kur vlera kontabël e aktivit apo e pasivit rikuperohet apo shlyhet, rezultojnë në shumat të zbritshme në llogaritjen e fitimit të tatueshëm si dhe nga humbjet fiskale që mbarten në periudhat e ardhme.

Detyrime tatimore të shtyra janë shumat e tatimit mbi fitimin që do të paguhet në periudhat e ardhme dhe që lindin nga diferencat e përkohshme të tatueshme, të cilat janë diferenca të përkohshme që në periudhat e ardhme, kur aktivit apo pasivi do të rikuperohet apo shlyhet çojnë në shumat të tatueshme. Për vitin 2019 shoqëria ka njohur aktivet tatimore të shtyra.

### 3.12 Qiratë

Shoqëria zbaton për herë të parë SNRF 16 për periudhën raportuese të vitit 2019. Sipas SNRF 16 "Qiratë" shoqëria i klasifikon qiratë në qira me vlerë të vogël, në qira afatshkurtëra dhe në qira. Një qira është një kontratë ose një pjesë e një kontrate, e cila transferon të drejtën e përdorimit të një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe të caktuar kundrejt pagesave. Shoqëria kontratat që përmbajnë një qira i kontabilizon elementët qira të kontratës si një qira veçmas nga ata elementë që nuk paraqesin një qira.

Qiraja afatshkurtër përcaktohet si qira që nuk përmban një mundësi blerjeje dhe e cila në datën e fillimit, ka një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak. Për tu konsideruar "afatshkurtër" qiraja duhet të ketë një afat maksimal të qirasë 12 muaj, pa ndonjë mundësi shtesë që mund të ushtrohet me diskrecionin e vetëm të shoqërisë. Për qiratë afatshkurtëra dhe ato me vlerë të vogël shoqëria i njeh pagesat e qirasë në shpenzimet e periudhës.

Për secilën kontratë të qirasë, shoqëria fillimisht njeh një aktiv për të drejtën e përdorimit dhe një detyrim të qirasë. Në datën e fillimit të qirasë, aktivi i së drejtës të përdorimit matet me koston që përfshin shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë, çdo pagesë të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, minus çdo incetiv të qirasë, çdo kosto fillestare direkte të shkaktuar si dhe kostot e vlerësuar të rikthimit. Në datën e fillimit shoqëria mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë duhet të skontohen duke përdorur një normë rritëse të huamarrjes. Shoqëria përdor normën rritëse të huamarrjes si norma e skontimit që zbatohet për pagesat e qirasë, e përcaktuar si normë pa risk në vendin në të cilin është nënshkruar marrëveshja (bazuar në kohëzgjatjen specifike të marrëveshjeve).

## Alban.Del shpk

### PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

#### 3.12. Qiratë-Vazhdim

Norma rritëse e interesit të huamarrjes është norma e interesit që një qiramarrës do të duhet të paguajë për të marrë hua për një afat të ngjashëm, dhe me një siguri të ngjashme, fondet e nevojshme për të marrë një aktiv të një vlere të ngjashme me aktivin e së drejtës të përdorimit në një mjedis të ngjashëm ekonomik. Norma e skontimit e përdorur në datën e fillimit mbetet e pandryshuar gjatë periudhës së qirasë; përveç nëse një modifikim / rivlerësim i detyrimit të qirasë ndodh gjatë afatit të qirasë. Shoqëria përdor normën rritëse të interesit duke u bazuar në afatin e kontratës si më poshtë:

		Norma rritëse e interesit					
Afati kontratës	i	1 Vit	2 Vite	3 Vite	5 Vite	7 Vite	10 Vite
Norma e interesit	e	1.9%	1.9%	2.56%	3.73 %	3.73%	4.21 %

Shoqëria e vlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit (EDPA) duke përdorur modelin e kostos, sepse ajo përdor modelin e kostos për të gjitha aktivet e saj afatgjata. Sipas këtij modeli, EDPA është matur me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga zhvlerësimi; dhe e rregulluar për çdo rivlerësim të detyrimit të qirasë.

Amortizimit i të drejtës së përdorimit të aktivit bëhet me metodën e amortizimit linear, përgjatë jetës së dobishme të caktuar për këtë aktiv. Pas datës së fillimit, detyrimi i qirasë matet duke rritur vlerën kontabël për të pasqyruar interesin mbi detyrimin e qirasë, duke e zvogëluar vlerën kontabël me pagesat e qirasë të bëra dhe duke rimatur vlerën e mbetur kontabël për të pasqyruar çdo rivlerësim ose qira. Shoqëria ka matur detyrimin e qirasë dhe EDPA për qiranë e klasifikuar më parë si një qira operative bazuar në metodën e cumulative catch-up. Sipas kësaj metode detyrimi i qirasë është matur në vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, duke u zvogëluar bazuar në normën rritëse të huamarrjes të qiramarrësit, në datën e aplikimit fillestar. (SNRF 16.c8 (a)). E drejta e përdorimit të aktivit, të qirave të klasifikuar më parë si një qira operative matet në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë, e rregulluar me shumën e çdo pagese qiraje të parapaguar ose të akorduar në lidhje me atë qira të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar menjëherë para datës të aplikimit fillestar. Shoqëria zbaton metodën e cumulative catch-up për kontabilizimin e qirave të klasifikuara në periudhat e mëparshme si qira financiare. Sipas kësaj metode EDPA dhe detyrimet e qirasë maten me shumën kontabël në datën e aplikimit fillestar të SNRF 16, kështu që ato maten me shumën e mbartura të aktivit të qirasë dhe detyrimin e qirasë menjëherë para datës së së matjes duke aplikuar SNK 17.

#### 3.13 Menaxhimi i Riskut

##### 3.13.1 Manaxhimi riskut financiar

Aktivitetet e shoqërisë janë të ekspozuara ndaj një shumëllojshmërie risqesh financiare të cilat vijnë nga aktiviteti e saj të prodhimit dhe të financimit, risqe të tilla si (i) risku i kreditimit, (ii) risku i likuiditetit dhe (iii) risku i tregut.

Ky shënim jep informacion në lidhje me ekspozimin e shoqërisë ndaj secilit prej këtyre risqeve, objektivat, politikat dhe procedurat e shoqërisë për vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve dhe të menaxhimit të kapitalit. Informacion tjetër sasior jepet edhe gjatë trajtimit në këto pasqyra financiare.

Drejtimi i shoqërisë mbikqyr, vendos dhe zbaton kuadrin e menaxhimit të risqeve të shoqërisë. Drejtimi implementon dhe monitoron përputhshmërinë me politikat e menaxhimit të riskut.



## Alban.Del shpk

### PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

#### 3.13.1 Manaxhimi riskut financiar-Vazhdim

Politikat e menaxhimit të riskut të shoqërisë vendosen për të identifikuar dhe analizuar risqet me të cilat përballet shoqëria, për të caktuar limite dhe kontrole të përshtatshme të riskut dhe për të monitoruar përshtatshmërinë me kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë si dhe për të patur një balancim të përshtatshëm midis riskut dhe kthimeve dhe të minimizojë efektet potenciale të kundërta në performancën financiare të shoqërisë. Drejtuesi i shoqërisë ka të gjithë përgjegjësinë për përpilimin dhe aprovimin e politikave të manaxhimit të riskut. Ai ka implementuar dhe monitoron zbatimin e politikave të manaxhimit të riskut duke vendosur limitet perkatese të riskut dhe kontrollon dhe monitoron risqet me kushtet e tregut dhe të aktivitetit të kompanisë.

#### 3.13.2 Risku i tregut

Risku i tregut është risku i ndryshimit në cmimet e tregut, të tilla si në kurset e këmbimit, normat e interesit dhe cmimet e të mirave, që do të ndikojnë në të ardhurat e shoqërisë ose në vlerën e instrumenteve financiare të saj. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është që të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimet ndaj riskut brenda parametrave të pranueshëm dhe të optimizojë kthimet.

Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2019

	LEK	Euro	TOTAL
Aktivitet Afatshkurter	230,135,124	827,581	230,962,705
Aktivitet Afatgjate	264,246,143	0	264,246,143
<b>Total</b>	<b>494,381,267</b>	<b>827,581</b>	<b>495,208,848</b>
Detyrimet afatshkurter	159,866,116	-64,893,741	94,972,374
Detyrimet afatgjate		204,071,560	204,071,560
Kapitali aksioner	196,164,914	0	196,164,914
<b>Total</b>	<b>356,031,029</b>	<b>139,177,818</b>	<b>495,208,848</b>
<b>GAP me 31 dhjetor</b>	<b>138,350,237</b>	<b>-138,350,237</b>	<b>0</b>

Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2018

	LEK	Euro	TOTAL
Aktivitet Afatshkurter	170,689,933	97,259,736	267,949,668
Aktivitet Afatgjate	193,541,317	0	193,541,317
<b>Total</b>	<b>364,231,250</b>	<b>97,259,736</b>	<b>461,490,986</b>
Detyrimet afatshkurter	65,334,887	51,431,819	116,766,706
Detyrimet afatgjate		161,270,819	161,270,819
Kapitali	183,453,461	0	183,453,461
<b>Total</b>	<b>248,788,348</b>	<b>212,702,638</b>	<b>461,490,986</b>
<b>GAP me 31 dhjetor</b>	<b>115,442,902</b>	<b>-115,442,902</b>	<b>0</b>

#### - Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria ekspozohet ndaj efekteve të luhatjeve të normave ekzistuese të kursit të këmbimit në pozicionin e saj financiar dhe flukset e Mjeteve Monetare. Risqet e kursit të këmbimit paraqesin riskun që vlera e drejtë e flukseve të ardhme të mjeteve monetare të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit. Risqet e kursit të këmbimit lindin kur transaksionet e ardhshme tregëtare ose aktivet ose detyrimet e njohura janë të shprehura në një monedhë e cila nuk është monedha funksionale e Shoqërisë LEK. Bazuar në monedhën e kryerjes së transaksionit gjatë vitit situata e aktiveve dhe detyime sipas monedhave paraqitet si vijon:

**Alban.Del shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

*-Risku i likuiditetit*

Risku i likuiditetit paraqet rrezikun qe shoqëria të mos jetë në gjendje qe të shlyejë detyrimet e saj financiare në datën e maturimit. Metoda e shoqërisë për të menaxhuar riskun e likuiditetit është qe të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur, mbajtjen gjëndje të një sasi të mjaftueshme të mjeteve monetare për të paguar detyrimet në datën e maturimit si në kushtet normale ashtu dhe në kushtet e presionit pa shkaktuar humbje të papranueshme apo pa dëmtuar reputacionin e shoqërisë. Normalisht shoqëria sigurohet qe të ketë mjete monetare të mjaftueshme për të paguar shpenzimet e saj operationale të ardhme për një periudhë minimale prej 30 ditësh. Nje paraqitje e Aktiveve dhe detyrimeve sipas maturitetit fillestar jepet në vijim:

**Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2019**

	Deri ne 30 dite	31 -90	91 -180	181 -365	Mbi 1 vit	TOTAL
Aktivët Afatshkurter	176,584,843	922,205	7,522,384	33,052,153	12,881,120	230,962,705
Aktivët Afatgjata	-				264,246,143	264,246,143
<b>Total</b>	<b>176,584,843</b>	<b>922,205</b>	<b>7,522,384</b>	<b>33,052,153</b>	<b>277,127,263</b>	<b>495,208,848</b>
Detyrimët Afatshkurter	68,368,923	12,280,600	4,887,897	9,434,954		94,972,374
Detyrimët afatgjata					204,071,560	204,071,560
Kapitali aksionr					196,164,914	196,164,914
<b>Total</b>	<b>68,368,923</b>	<b>12,280,600</b>	<b>4,887,897</b>	<b>9,434,954</b>	<b>400,236,474</b>	<b>495,208,848</b>
<b>GAP me 31 dhjetor</b>	<b>108,215,919</b>	<b>-11,358,396</b>	<b>2,634,488</b>	<b>23,617,199</b>	<b>-123,109,210</b>	<b>0</b>

**Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2018**

	Deri ne 30 dite	31 -90	91 -180	181 -365	Mbi 1 vit	TOTAL
Aktivët Afatshkurter	163,484,802	106,927	7,522,384	61,893,942	34,941,613	267,949,668
Aktivët Afatgjata	-				193,541,317	193,541,317
<b>Total</b>	<b>163,484,802</b>	<b>106,927</b>	<b>7,522,384</b>	<b>61,893,942</b>	<b>228,482,930</b>	<b>461,490,986</b>
Detyrimët Afatshkurter	57,821,534	58,945,172				116,766,706
Detyrimët afatgjata					161,270,819	161,270,819
Kapitali aksionr					183,453,461	183,453,461
<b>Total</b>	<b>57,821,534</b>	<b>58,945,172</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>344,724,280</b>	<b>461,490,986</b>
<b>GAP me 31 dhjetor</b>	<b>105,663,268</b>	<b>-58,838,245</b>	<b>7,522,384</b>	<b>61,893,942</b>	<b>-116,241,350</b>	<b>0</b>

*Risku i kreditimit*

Risku i kreditimit është rreziku i humbjeve qe mund t'i vijne shoqërisë nëse klienti ose pala tjetër e një instrumenti financiar të mos shlyejë detyrimet e veta kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme ndaj klientëve të shoqërisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj riskut të kreditimit është vlere e mbetur e llogarive të arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve afatgjata. Risku i kreditimit lidhet me mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare, me depozitat bankare dhe me ekspozimin ndaj klienteve dhe të arkëtueshmeve të tjera.

Kontrolli dhe menaxhimi i riskut të kreditimit është përgjegjësi e drejtimit të shoqërisë. Më poshtë jepet një listë ekspozimi krediti; për më tepër informacion për këtë lloj ekspozimi qe mbartin këto zëra referojuni shënimeve 4.5, 6.

**Alban.Del shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKE, PËRNDRYSHË SHKRUHET

*Risku i kreditimit – vazhdim*

	<b>Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor</b>	
	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Arka dhe Llogari prane Bankave	27,930,080	4,762,078
Llogarite e Arketueshme	88,412,909	90,082,191
<b>Total</b>	<b>116,342,989</b>	<b>94,844,269</b>

*-Manaxhimi i riskut të kapitalit*

Objektivat e shoqërisë në lidhje me manaxhimin e kapitalit janë që të mbajë një bazë të fortë të kapitalit, në mënyrë që kështu të mbaje besueshmërinë e investitorëve, kreditorëve, dhe të tregut në qëndrueshmërinë e zhvillimit të aktiviteteve të saj. Shoqëria menaxhon strukturën e kapitalit të saj dhe bën ndryshimet përkatëse bazuar në ndryshimet e kushteve ekonomike dhe karakteristikave të riskut të aktiveve të saj. Shoqëria merr parasysh në strukturën e kapitalit të saj kapitalin e vet, huat afatgjata dhe kapitalin punues. Shoqëria monitoron kapitalin e saj mbi bazën e raportit të borxhit me kapitalin total.

Borxhi neto llogaritet bazuar në gjendjen e huave afatgjata dhe huatë afatshkurtra të paraqitura në bilancin kontabël minus gjendjen e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Kapitali total llogaritet si vlera e kapitalit që paraqitet në bilancin kontabël plus huan neto. Për të monitoruar këtë raport shoqëria përgatit buxhetet vjetore të shpenzimeve të cilat përditësohen në vartësi të ndryshimit të faktorëve përfshirë cmimet aktuale dhe ato të parashikuara, suksesit të sigurimit të kapitalit dhe kushteve të industrisë. Buxhetet vjetore të përditësuara aprovohen nga Drejtimi i Shoqërisë. Në fund të vitit 2019, shoqëria ka një surplus të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të mjeteve monetare (edhe në vitin 2018 ishte gjithashtu surplus). Shoqëria nuk ka deklaruar dhe paguar dividendë që nga data e krijimit të saj dhe nuk parashikon të deklarojë as në të ardhmen.

**4. Mjetet monetare**

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë.

Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2019 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat. Gjendja e mjeteve monetare dhe të ngjashme në fund të periudhës 2019 paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Arka dhe mjete te tjera ne Arke	258,810	385,367
Llogari Rrjedhese me Bankat	27,671,270	4,376,710
<b>Total</b>	<b>27,930,080</b>	<b>4,762,078</b>

Një paraqitje e shumave të vendosura në institucionet financiare jepet ne vijim:

**Alban.Del shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

**4. Mjetet monetare (Vazhdim)**

Mjete Monetare prane bankave		31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
<b>Pershkrimi</b>			
	Vendosje Ne lek		
Llogari Rrjedhese prane Bankave		3,644,062	1,856,058
Depozita prane Bankave		-	-
	Vendosje Ne Monedhe te huaj		
Llogari Rrjedhese prane Bankave		24,027,208	2,520,652
Depozita prane Bankave		-	-
<b>Total</b>		<b>27,671,270</b>	<b>4,376,710</b>
<b>Mjete Monetare ne monedhe te huaj prane bankave</b>			
<b>Pershkrimi i Llogarive</b>		<b>31 Dhjetor 19</b>	<b>31-Dhjetor-18</b>
Veneto Banka		-	-
Llogari Rrjedhese prane Bankave		-	-
Depozita prane Bankave		-	-
Banka Intesa san Paolo		-	-
Llogari Rrjedhese prane Bankave		24,027,208	2,520,652
Depozita prane Bankave		-	-
<b>Total</b>		<b>24,027,208</b>	<b>2,520,652</b>

**5. Llogari/Kërkesa të arkëtueshme**

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve gjendje të paarkëtuar më 31 Dhjetor 2019. Ato paraqiten me vlerën neto nga zhvlerësimi nga borxhi i keq. Shoqëria nuk ka llogaritur borxh të keq për vitin 2019. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientëve jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi		31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
	Llogari te Arketueshme -Faturimet	88,412,909	90,082,191
<b>Total</b>		<b>88,412,909</b>	<b>90,082,191</b>

Dinamika e të drejtave ndaj klientëve gjatë vitit 2019 paraqitet si vijon:

Pershkrimi		31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Gjendja 01 Janar		90,082,191	46,047,073
	Rritjet Gjate periudhes ushtrimore	739,934,671	628,694,637
	Pakesimit gjate periudhes ushtrimore	(739,676,423)	(582,705,939)
	Rritje/( pakesime ) Diferencat e kembimit	(1,927,530)	(1,953,579)
<b>Gjendja 31 Dhjetor</b>		<b>88,412,909</b>	<b>90,082,191</b>

**6. Kerkesa të arkëtueshme të tjera**

Në këtë zë të bilancit paraqiten kërkesat e shoqërisë ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjen e shërbimeve dhe të mallrave. Një paraqitje e detajuar e këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

**Alban.Del shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

## 6. Kërkesa të arkëtueshme të tjera-Vazhdim

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Paradhenie per shtetin TVSH Kreditueshme	33,052,153	61,893,942
TVSH e kerkuar per rimbursim	-	22,753,326
Parapagime per shtetin Tatim Fitimi	7,522,384	7,522,384
Te drejta ndaj ISSSHS	-	-
Garanci te paguara	4,885,107	4,885,107
Te Tjera	241,969	343,127
<b>Total</b>	<b>45,701,613</b>	<b>97,397,886</b>

## 7. Inventarët

Shoqëria përdor disa lloje të inventarëve të nevojshëm për aktivitetin e vet. Ajo përdor metodën e inventarizimit periodik për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventaret janë vlerësuar me kosto e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si me e vogla e krahasuar me vlerën neto të realizueshme. Inventarët paraqiten si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Lende e Pare	18,475,205	23,205,338
Prodhim ne Proces	15,704,392	6,064,262
Produkt i Gatshem	26,062,257	16,617,607
<b>Total</b>	<b>60,241,853</b>	<b>45,887,208</b>

Gjendja e Lëndëve të para përbëhet nga materiale ndihmese që përdoren për procesin e prodhimit. Inventari i prodhimit në proces paraqet gjendjen në datën e bilancit të materialeve që ndodhen në procesin e prodhimit ende të papërfunduar. Ato janë vlerësuar me vlerën e shpenzimeve të kryera deri në atë datë.

Në zërin e produkteve të gatshme paraqiten produktet e gatshme, faqe këpuce, të cilat janë përfunduar dhe janë të gatshme për tu eksportuar tek klienti. Ato janë të vlerësuar me tërësinë e shpenzimeve të kryera nga shoqëria për prodhimin e tyre.

Shoqëria përlllogarit koston e produktit bazuar në evidentimin e kostove direkte që ajo realizon gjatë procesit të prodhimit si dhe në shpërndarjen e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit. Për më shume informacion referojuni shënimit 3.4 paragrafi a).

## 8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Paraqesin shumat e shpenzimeve të kryera dhe që do të shpërndahen në periudhat e ardhme. Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet në tabelën më poshtë:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Shpenzime te parapaguara	1,678,929	23,638,263
Parapagime Furnitori per sherbime	6,997,320	6,182,043
<b>Total</b>	<b>8,676,249</b>	<b>29,820,306</b>

Në shpenzimet e parapaguara janë përfshirë shpenzimet e shtyra për sigurimet e pasurisë dhe të punonjësve, të makinave, të mirëmbajtjes, etj. Parapagime furnitori paraqet shumën e pagesave të bëra për shërbime ende të pakryera.

## Alban.Del shpk

### PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

#### 9. Aktivet Afatgjata

Gjendja dhe shtesat e pakësimit e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2019 paraqiten si në tabelën vijuese:

##### Pasqyra e ndryshimit të AAM

	E drejta e Perdorimit të aktiveve	Makineri e pajisje pune	Aktive te tjera Afatgjata	Kompjuterat dhe te ngjashme	AAM ne proces	Total
<b>Gjendja 31 Dhjetor 2017</b>		<b>149,649,633</b>	<b>196,274,267</b>	<b>20,555,255</b>	<b>0</b>	<b>366,479,156</b>
Blerjet gjatë viti ushtrimor		5,138,836	51,777,912	4,328,987		61,245,735
Shitjet gjatë viti ushtrimor			(2,580,552)			(2,580,552)
Nxjerrje jashte perdorimit						0
Riklasifikime						0
Pakësime/Shtesa të tjera						0
<b>Gjendja 31 Dhjetor 2018</b>		<b>154,788,469</b>	<b>245,471,626</b>	<b>24,884,242</b>	<b>-</b>	<b>425,144,560</b>
Blerjet gjatë viti ushtrimor		5,985,255	48,805,605	540,430		55,331,290
Shitjet gjatë viti ushtrimor			(4,750,815)			(4,750,815)
Nxjerrje jashte perdorimit						0
Riklasifikime						0
Pakësime/Shtesa të tjera	108,467,804					108,467,804
<b>Gjendja 31 Dhjetor 2019</b>	<b>108,467,804</b>	<b>160,773,946</b>	<b>289,526,416</b>	<b>25,424,672</b>	<b>-</b>	<b>584,192,839</b>

##### Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM

	E drejta e perdorimit te aktiveve	Makineri e pajisje pune	Aktive te tjera Afatgjata	Kompjuterat dhe te ngjashme	AAM ne proces	Total
<b>Amortizimi AAM gjendje me 31.12.2017</b>	-	<b>83,957,731</b>	<b>103,730,710</b>	<b>8,194,255</b>	<b>-</b>	<b>195,882,695</b>
Amortizimi i periudhes ushtrimore		13,892,063	34,970,705	4,675,563		53,538,331
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes						0
Amortizimi i AAM te shitura			(357,073)			(357,073)
Amortizimi i AAM te Nxjerra jashte perdorimit						0
Amortizimi I AAM të Riklasifikuara						0
<b>Amortizimi AAM gjendje me 31.12.2018</b>	-	<b>97,850,015</b>	<b>138,344,342</b>	<b>12,869,818</b>	<b>-</b>	<b>249,064,175</b>
Amortizimi i periudhes ushtrimore	26,749,239	13,687,155	44,278,985	4,800,283		89,515,661
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes						0
Amortizimi i AAM te shitura			(3,591,138)			(3,591,138)
Amortizimi i AAM te Nxjerra jashte perdorimit						0
Amortizimi I AAM të Riklasifikuara	171,716		(171,716)			0
<b>Amortizimi i AAM gjendje me 31.12.2019</b>	<b>26,920,954</b>	<b>111,537,170</b>	<b>178,860,473</b>	<b>17,670,101</b>	<b>-</b>	<b>334,988,699</b>
<b>VKN 31 12 2018</b>	-	<b>56,938,676</b>	<b>107,127,285</b>	<b>12,014,424</b>	<b>-</b>	<b>176,080,385</b>
<b>VKN 31 12 2019</b>	<b>81,546,850</b>	<b>49,236,776</b>	<b>110,665,943</b>	<b>7,754,571</b>	<b>-</b>	<b>249,204,140</b>

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar. Shitja e aktiveve afatgjata të tjera paraqet kryesisht vlefën e formave e fustelave të cilat shiten në Itali tek shoqëria mëmë, si dhe shitja e nje makine dhe riklasifikimi i aktivitet me qira financiare ne zbatim të kërkesave të SNRF 16. Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Per aktivet AAM te dala eshte llogaritur amortizim per periudhën e përdorur deri në momentin e daljes jashtë shoqërisë.

## Alban.Del shpk

### PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

#### 9. Aktivët Afatgjatë-Vazhdim

Normat e amortizimit të përdorura (referoju shënimit 3.5 (ii)), janë në përputhje me kërkesat e SNK 16, dhe SNK 36 për të siguruar një shpërndarje të saktë të kostos së AAM në koston e periudhave që ato përdoren për sigurimin e të ardhurave. Diferencat në shpenzimet e amortizimit nga përdorimi i këtyre metodave dhe normave dhe metodave të amortizimit të përdorura nga shoqëria me ato fiskale janë marrë në konsideratë në llogaritjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin. Shoqëria në zbatim të SNRF 16 "Qiratë" ka njohur dhe aktivet për të Drejtën e Përdorimit të ndërtesave të fabrikës dhe të automjeteve si aktive afatgjatë. Amortizimi i tyre është llogaritur duke patur parasysh afatin e cdo kontrate qiraje. Për më shumë në lidhje me trajtimin kontabël të tyre referojuni shënimit 3.12. Në tabelën në vijim paraqitet dinamika në lidhje me aktivet nga EDPA.

Pasqyra e levizjes Te së drejtes se perdorimit te Aktivëve

	Celja me 01.01.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendja me 31.12.2019
E DPA e ndërtesave	102,548,504	-	-	102,548,504
EDA e mjeteve të transportit	5,919,300	-	-	5,919,300
<b>Totali</b>	<b>108,467,804</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>108,467,804</b>

	Gjendja me 01.01.2019	Amortizimi i vitit	Pakesime	Gjendja me 31.12.2019
Amortizimi i të EDPA të ndërtesave	-	25,178,229	-	25,178,229
Amortizimi i EDA e mjeteve të transportit	171,716	1,571,009	-	1,742,725
<b>Totali</b>	<b>171,716</b>	<b>26,749,239</b>	<b>-</b>	<b>26,920,954</b>

<b>Vlera kontabël neto</b>	<b>108,296,088</b>	<b>-26,749,239</b>	<b>81,546,850</b>

#### 10. Aktivët dhe Detyrimet tatimore të shtyra

Në lidhje me perlllogaritjen e tatimit të shtyre shoqëria aplikon kërkesat e SNK 12 për Tatim Fitimin dhe rrjedhimisht kërkesat për njohjen dhe vlerësimin e tatimit të shtyrë, bazuar në politikën kontabël pershkruar në shënimin 3.11.

Shoqëria ka llogaritur diferencat e përkohshme midis bazës kontabël me bazën e tatueshme të AAM. Gjithashtu shoqëria ka paraqitur edhe të drejtën që ka për të mbartur humbjen fiskale të rezultuar në vitin 2017 dhe 2018, në vitet pasardhëse, duke njohur një aktiv tatimor. Këto diferenca rezultojnë si në tabelën vijuese:

	Viti 2019	Viti 2018
Vlera kontabël neto e Aktivëve	249,204,140	176,080,385
Vlera tatimore e aktiveve	301,625,982	212,613,918
Diferenca e përkohshme	(52,421,843)	(36,533,533)
Tarifa e tatimit mbi fitimin	15%	15%
<b>Aktiv tatimor i shtyrë</b>	<b>-7,863,276</b>	<b>-5,480,030</b>
Humbja Fiskale (e drejta për tu mbartur)	32,014,498	-41,270,570
Gjendje 01.01.	-79,872,682	-38,602,112
Pakesime	-	-
Gjendje 31.12.	-47,858,184	-79,872,682
Tarifa e tatimit mbi fitimin	15%	15%
<b>Aktiv tatimor i shtyrë</b>	<b>-7,178,728</b>	<b>-11,980,902</b>
<b>Total Aktiv tatimor i shtyrë</b>	<b>-15,042,003</b>	<b>-17,460,932</b>

## Alban.Del shpk

### PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

#### 11. Detyrimet afatshkurtëra

##### 11.a. Detyrime për qira

Në këtë zë paraqitet shuma e detyrimeve për qiratë që ka shoqëria dhe që maturohen për tu paguar në vitin 2020. Për trajtimin kontabël të tyre referoju shënimin 3.12

##### 11.b Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2019. Detyrimet ndaj furnitorëve në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit dhe diferencat kanë kaluar në rezultat. Përbërja e këtyre detyrimeve paraqiten si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Furnitore te aktivitetit Kryesor	59,057,971	110,592,579
Fatura per te Mberritur	1,251,960	182,727
<b>Total</b>	<b>60,309,931</b>	<b>110,775,306</b>

Në furnitorët e aktivitetit kryesor peshën kryesore e kap detyrimi ndaj Shoqërisë TOD's S.p.A, furnitorëve të tjerë të huaj për nënkontraktime të ndryshme si qëndisje, preje, qepje si dhe furnitorëve vendas të tjerë, për shërbime të ndryshme si dhe nënkontraktime si qendisje, preje, qepje etj, etj.

Në furnitorët për fatura për t'u mbërritur janë përfshirë detyrimet e llogaritura për shërbimet e kryera në muajin dhjetor 2019 por që faturat kanë ardhur në muajin janar 2020, si psh telefoni, etj. Dinamika e detyrimeve ndaj furnitorëve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	Viti 2019	Viti 2018
<b>Gjendja 01 Janar</b>	<b>110,775,306</b>	<b>60,762,494</b>
Rritjet gjate periudhes ushtrimore	554,600,798	664,799,324
Pakesimit gjate periudhes ushtrimore	-604,704,845	-612,093,887
Rritje/( pakesime ) Diferencat e kembimit	-361,328	-2,692,625
<b>Gjendja 31 Dhjetor</b>	<b>60,309,931</b>	<b>110,775,306</b>

#### 12. Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë paraqiten detyrimet për pagat e llogaritura dhe të papaguara për stafin drejtues dhe punonjësit për muajin dhjetor. Në fund të vitit 2019 shoqëria ka detyrime për pagat e papaguara ndaj punonjësve të cilat janë paguar në muajin Janar 2020. Përbërja e këtyre detyrimeve paraqiten si vijon:

Pershkrimi I Llogarive	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Detyrime per paga	9,703,338	645,877
<b>Total</b>	<b>9,703,338</b>	<b>645,877</b>

#### 13. Detyrimet tatimore

Në këtë paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimet e taksat si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31 Dhjetor -19	31 Dhjetor 18
Shteti Sigurimet Shoqerore e Shendetore	3,361,440	3,253,948
Shteti Tatim Mbi te Ardhurat Personale	2,124,772	1,811,840
Shteti te Tjera Tatim Taksa	432,566	279,735
<b>Total</b>	<b>5,918,777</b>	<b>5,345,522</b>



**Alban.Del shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

### 13. Detyrimet tatimore-Vazhdim

Në detyrimet për Shtetin Tatim mbi te ardhurat personale paraqitet detyrimi për tatimin mbi të ardhurat nga pagat për muajin dhjetor 2019 i cili është paguar në janar të vitit 2020. Kurse në detyrimet për Tatime e Taksa të tjera paraqitet detyrimi për tatimin në burim që do paguhet në janar të vitit 2020.

### 14. Detyrime për Qiratë

Në këtë zë paraqitet pjesa afatgjatë e detyrimit për kontratat e qirave që shoqëria ka lidhur për përdorimin e ndërtesave të fabrikës dhe të automjeteve. Njohja e këtij detyrimi është bërë në përputhje me SNRF 16. Referoju shënimit 3.12 për më shumë. Shuma e vitit 2018 paraqet detyrimin nga qiraja financiare e njohur sipas SNK 17.

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Detyrime afatgjata nga qiraja	47,719,708	2,059,019
<b>Total</b>	<b>47,719,708</b>	<b>2,059,019</b>

### 15. Hua afatgjata

Në këtë zë paraqitet huaja afatgjata që shoqëria ka marrë për të plotësuar nevojat e saj për likuiditete e cila paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor -19	31 Dhjetor 18
Gjendja me 01 Janar	159,211,800	66,475,000
Rritje nga financimi	-	102,498,000
Rritje/pakesim kursi i këmbimit	(2,859,948)	(9,761,200)
Pakesim nga shlyerja	-	-
<b>Gjendja më 31.12</b>	<b>156,351,852</b>	<b>159,211,800</b>

### 16. Kapitalet e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2019, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor -19	31 Dhjetor 18
Kapitali i paguar	97,338,400	97,338,400
Rezerva ligjore	8,398,298	8,398,298
Fitimi (Humbja) i/e vitit te kaluar	77,716,763	120,226,032
Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar	12,711,453	(42,509,269)
<b>Total</b>	<b>196,164,914</b>	<b>183,453,461</b>

Fitimi i vitit financiar është ai që rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2019.

### 17. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

## Alban.Del shpk

PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

### 17.1 Shitjet neto

Shoqëria realizon të ardhurat kryesore të aktivitetit të saj që është kryerja e shërbimit të prodhimit të faqeve të këpucëve me material të porositësit.

Pershkrimi	31 Dhjetor -19	31 Dhjetor 18
Te ardhura nga shitja e Shërbimeve	702,747,514	620,996,595
<b>Total</b>	<b>702,747,514</b>	<b>620,996,595</b>

### 17.2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet dhe të ardhurat si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Të ardhurat neto nga shitje e AAGJ	1,209,832	153,834
<b>Total</b>	<b>1,209,832</b>	<b>153,834</b>

Të ardhurat neto nga AAM të shitura paraqesin fitimet neto nga shitja e disa aktiveve, si modele, etj. të cilat pasi përdoren eksportohen duke u shitur përsëri tek furnitori i tyre.

### 18. Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe gjysëm produkteve

Në këtë zë të PASH janë përfshirë shpenzimet nga pakësimi i produkteve të gatshme dhe nga pakësimi i gjysëm produkteve si në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Gjendja e Gjysëm Produkteve Fillim	6,064,262	5,366,096
Gjendja e Gjysëm produkteve në fund	15,704,392	6,064,262
<b>Ndryshimi neto</b>	<b>9,640,130</b>	<b>698,166</b>
Gjendja e Inventarit të PG Fillim	16,617,607	17,247,844
Gjendja e Inventarit të PG Fund	26,062,257	16,617,607
<b>Ndryshimi neto</b>	<b>9,444,650</b>	<b>-630,236</b>
<b>Totali i ndryshimit</b>	<b>19,084,779</b>	<b>67,930</b>

### 19. Shpenzimet e lëndëve të para e materialeve të tjera të konsumuara

Në këtë zë të PASH janë përfshirë kostoja e blerjes së materialeve të para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e shërbimit të prodhimit me porosi. Shoqëria merr nga porositësi në kushtet e regjimit të përkohshëm kryesisht vetëm lëkurën dhe disa materiale të tjera ndihmëse, kurse të gjitha materialet e tjera ndihmëse përgjithësisht i siguron duke i blerë nga furnitorët.

Në këtë zë kostoja e materialeve të konsumuara përfshin çmimin e blerjes së tyre plus dhe të gjitha shpenzimet e kryera për sigurimin e tyre, përfshirë edhe taksat dhe shpenzimet doganore. Një paraqitje e detajuar e përbërjes të këtij zëri të PASH paraqitet si në tabelën vijuese:

**Alban.Del shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

**19. Shpenzimet e lëndëve të para e materialeve të tjera të konsumuara-Vazhdim**

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Gjendja e Mallrave/ Produkteve ne Fillim	(23,205,338)	(20,731,112)
Blerje Materialelesh te para	10,852,158	9,726,568
Blerje Materialelesh ndihmese	64,615,866	47,743,563
Shpenzime utilitare (energj elektrike, uje,)	9,370,568	9,224,521
Shpenzime Doganore dhe Taksa te mallrave dhe produkteve	3,613,022	6,648,188
Gjendja e Mallrave/ Produkteve ne Fund	18,475,205	23,205,338
<b>Total</b>	<b>83,721,480</b>	<b>75,817,066</b>

Në zërin “Blerje Materialelesh te Para” përfshihet vlefata e materialeve të blera për aktivitetin, si p.sh fije qepës, si dhe shuma e shpenzimeve për materiale ndihmese të cilat përfshijnë materiale si lapsa për shënim në lëkurë, materiale adesive, ngjitës të ndryshëm etj..

**20. Shpenzime personeli**

Në shpenzimet per personelin, jane përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2019. Gjatë vitit 2019 shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punonjësit. Përbërja e nënzërit të shpenzimeve të pagave paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Pagat		
Menaxhimi	31,505,012	10,674,450
Puntoret	124,658,014	151,906,986
Shperblime	9,422,656	8,509,965
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore	24,567,555	25,322,701
Shpenzime te tjera per personelin	-	91,121
<b>Total</b>	<b>190,153,237</b>	<b>196,505,223</b>

Në zërin Shpërblime paraqiten shpërblimet e dhëna punonjësve për performancën nga shoqëria në vitin 2019.

Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetsore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifatat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetsore.

**21. Amortizimi dhe zhvlerësimet**

Në këtë zë të shpenzimeve paraqitet shuma e amortizimit të aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë. Llogaritja e shpenzimeve të amortizimit është bërë në përputhje me politikat kontabël të shoqërisë. Referoju shënimit 3.5 dhe 9.

## Alban.Del shpk

### PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

#### 22. Shpenzimet e tjera

Perberja e ketij zeri te shpenzimeve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Shpenzime zyre	896,403	3,614,975
Qera	26,806	27,762,587
Shpenzime Sigurimi Biznesi	3,763,660	3,623,901
Shpenzime Ligjore, Kontabel, Inxhinierike dhe auditimi	17,426,834	16,141,749
Shpenzime Udhetimi dhe te ngjashme	5,989,481	6,378,326
Shpenzime Komunikimi dhe te ngjashme	1,084,122	1,314,619
Shpenzime te tjera, Sherbime nga te Tretet	15,237,702	22,062,425
Shpenzime per taksat ( perjashtuar TVSH, Aksice, Tatim Fitimi)	2,910,722	2,007,202
Nenkontraktme sherbimesh - Punime te ndryshme	289,491,445	265,463,043
Te tjera	5,243,879	2,757,606
Diferenca nga Kursi i Kembimit Kliente Furnitore	(3,328,282)	(10,554,900)
<b>Total</b>	<b>338,742,772</b>	<b>340,571,534</b>

Shpenzimet e qerasë paraqesin kryesisht pagesat dhe llogaritjet e bëra për qeranë afatshkurtër për një autoveturë. Shpenzimet e qirase janë zvogëluar në raport me vitin e kaluar pasi sipas SNRF 16 ato tashme paraqiten si shpenzime amortizimi të EDPA. Shpenzimet e konsulencës paraqesin kostot e shërbimeve ligjore, kontabilitetit, noteriale, të shërbimit të sigurisë, etj. Shërbimet të tjera dhe nga të tretët paraqesin kostot e riparimeve dhe mirëmbajtjeve, të trainimit, paraqesin pagesat për transportin e punëtorëve, për transporte të tjera, të pastrimit, etj.

Shpenzimet për nënkontraktme shërbimesh paraqesin kryerje punimesh të ndryshme si qëndisje, preje, qepje të kryer nga nënkontratorët e shoqërisë brenda dhe jashtë vendit. Shpenzimet e tjera, paraqesin shpenzimet e panjohura nga ana tatimore, për gjobat e doganës, për pritje e përcjellje, për uniforma dhe trainime të stafit, etj.

#### 23. Të ardhurat dhe shpenzime për interesa

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Shpenzime nga Interesi	(3,675,024)	(902,206)
Komisione bankare	(1,110,138)	(1,030,778)
<b>Total</b>	<b>(4,785,162)</b>	<b>(1,932,984)</b>

Gjatë vitit 2019 ka patur hua të marra për të cilën paraqiten shpenzimet e interesit si në tabelë. Po ashtu shpenzimet e interesit përfshijnë edhe interesin për rimatjem e detyrimeve të qirasë për shkak të efektit në kohë të parasë. Komisionet bankare paraqesin pagesat e bëra për shërbimet nëpërmjet llogarive bankare të shoqërisë.

#### 24. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në mjete monetare në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjëndjeve të likuiditeteve të shprehura në monedhë të huaj. Paraqitja e tyre jepet në tabelen vijuese:

**Alban.Del shpk****PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

**24. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi-Vazhdim**

Pershkrimi	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Fitimi nga Kurset e kembimit		
Mjete Monetare	356,757	31,699
Humbje nga Kurset e kembimit		
Mjete Monetare	(1,350,187)	(2,724,199)
<b>Total</b>	<b>(993,430)</b>	<b>(2,692,500)</b>

**25. Tatimi aktual**

Shoqëria ka rezultuar me një fitim neto kontabël para tatimit prej 15.131 mijë lekë dhe fitim neto fiskal para tatimit prej 32.014 mijë lekë. Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2019 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qëllime fiskale një sërë shpenzimesh. Shoqëria ka marrë në konsideratë në llogaritjen e tatimit aktual mbi fitimin dhe humbjen e mbartur fiskale nga vitet 2017 dhe 2018 prej -79,873 mijë lekë. Pasi fitimi i vitit fiskal mbulohet nga humbja e viteve të mëparshme, shoqëria llogarit një humbje fiskale e cila mund të mbartet në vitet e ardhshme, prej 47,858 mijë lekë. Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2019 paraqiten si në tabelën vijuese:

	Viti 2019	Viti 2018
<b>Pasqyra e rezultatit tatimor</b>		
Fitimi i periudhës	<b>15,130,382</b>	<b>-49,839,278</b>
<b>Korrigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor</b>	<b>16,884,116</b>	<b>8,568,709</b>
<b>Shpenzime me dokumente jo të rregullta e te tjera</b>	<b>950,470</b>	<b>819,609</b>
<i>Riparime e nirembajtje autovetura</i>	0	0
<i>Shpenzime të tjera</i>	950,470	819,609
Shpenzime pritje e perfaqësimit teje normave	0	0
Gjoha Penalitete e te ngjashme	45,336	68,806
Amortizime e zhvlerësime teje Normave Fiskale	15,888,310	7,680,293
<b>Fitimi i tatueshëm i vitit</b>	<b>32,014,498</b>	<b>-41,270,570</b>
<b>Humbja fiskale e mbartur nga vitet e kaluara</b>	<b>-79,872,682</b>	<b>-38,602,112</b>
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	15%	15%
Tatimi aktual mbi fitimin	0	0
<b>Humbja fiskale per tu mbartur</b>	<b>-47,858,184</b>	<b>-79,872,682</b>
Detyrim per tatimin e shtyre i rimarre		
Ulja e shpenzimeve te tatimit per Aktivin tatimor te shtyre	2,418,929	-7,330,009
<b>Shpenzimi kontabel i tatimit mbi fitimin</b>	<b>2,418,929</b>	<b>-7,330,009</b>
<b>Fitimi neto i Bilancit</b>	<b>12,711,453</b>	<b>-42,509,269</b>

## Alban.Del shpk

### PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

#### 25.Tatimi aktual-Vazhdim

Shoqëria përdor norma amortizimi të disa grupeve të AAM më të ulta se sa normat tatimore dhe për disa grupe norma më të larta amortizim (referoju shënimit 3.5 (ii)). Po ashtu shoqëria përdor norma amortizimi bazuar mbi metodën e amortizimit linear dhe jo mbi vlerën e mbetur sipas ligjit tatimor. Për këtë arsye për vitin 2019 shoqëria ka llogaritur amortizimin fiskal më të lartë se amortizimi kontabël.

Nga këto diferenca shoqërisë i rezulton në fund të vitit 2019 diferenca të përkohshme e kreditueshme midis vlerës kontabël dhe asaj fiskale të aktiveve prej 52,421 mijë lekë dhe një aktiv tatimor i shtyrë prej 7,863 mijë lekësh, me një rritje vetëm për vitin 2019 prej 2,383 mijë lekë, shumë kjo e paraqitur në zë më vete në aktivin e bilancit. Ndërsa për humbjen fiskale 2019 që mbartet për 3 vitet e ardhme, prej 47,858 mijë lekë, shoqëria ka njohur një aktiv tatimor prej 7,178 mijë lekë. Kjo sjell që edhe në kontabilitet shpenzimi për tatimin mbi fitimin të jetë më i ulët se shpenzimi aktual për tatimin mbi fitimin për këtë shumë të aktivit tatimor të shtyrë. Në lidhje me aktivin tatimor të shtyrë referoju edhe shënimit 10.

#### 26.Transaksionet me palet e lidhura

Shoqëria është e zotëruar në masën 100% nga Shoqëria Tod's International BV me adresë në Amsterdam, P.Cornelisz Hoofstraat 74, 1071 CB e cila zotërohet 100% nga shoqëria TODS S.pA me seli në Itali. Sipas statutit të shoqërisë, organi më i lartë vendimmarrës është asamblea e ortakëve. Shoqëria drejtohet nga administratori i saj z. Umberto Macchi Di Cellere i cili, me anë të një prokure speciale, ka ngarkuar si përfaqësues të tij z. Aurela Bakushi.

Shoqëria ka identifikuar si palë të lidhura gjithë shoqëritë e zotëruara nga Tods SpA ashtu sic parashikohet nga SNK 24: Palet e lidhura.

Në paraqitje e shumave të transaksioneve të kryera me palët e lidhura gjatë vitit 2019 paraqitet si vijon:

#### Bilanci Kontabël:

	Periudha qe perfundoi me 31 Dhjetor	Viti 2019	Viti 2018
<b>Aktivët gjatë vitit</b>			
1. Aktive Afatgjata Materiale te tjera		47,378,799	42,274,489
2. Aktive Afatshkurtra e Materiale te tjera		42,135,403	43,431,676
3. Llogaritë te Arketueshme		739,934,671	628,694,637
<b>Totali</b>		<b>829,448,872</b>	<b>714,400,802</b>
<b>Detyrimet gjatë te vitit</b>			
1. Llogari te Pagueshme per furnizime		89,514,201	85,706,165
2. Hua Afatgjata		156,351,852	159,211,800
	Gjendja me 01.01.2019	159,211,800	66,475,000
	Rritje nga financimi	-	102,498,000
	Rritje/pakesim kursi i këmbimit	-2,859,948	-9,761,200
	Pakesim nga shlyerja	-	-
<b>Totali</b>		<b>245,866,053</b>	<b>244,917,965</b>

**Alban.Del shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

**26. Transaksionet me palet e lidhura - Vazhdim**

**Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve**

	Periudha qe perfundoi me 31 Dhjetor	2019	2018
<i>Te ardhura dhe shpenzime</i>			
Te Ardhura nga Shitja produkteve dhe te tjera		703,106,499	622,236,566
Shpenzime Blerje Mallrash		-42,135,403	-43,431,676
Shpenzime per Interesat		-	-
Rrogat dhe shperblime		-348,528	-361,183
<b>Totali</b>		<b>660,622,568</b>	<b>578,443,708</b>

Nje paraqitje e gjëndjeve më 31.12.2019 te llogarive me palët e lidhura jepen në vijim:

<b>Tepricat ne Fund te vitit</b>	<b>31.12.2019</b>	<b>31.12.2018</b>
1. Llogarit te Arketueshme	88,412,909	90,082,191
2. Llogari te Pagueshme per furnizime	9,135,615	69,943,771
3. Hua Afatgjata	156,351,852	159,211,800
<b>Totali</b>	<b>253,900,376</b>	<b>319,237,762</b>

**27. Ngjarjet mbas datës së bilancit**

Pas datës së mbylljes së periudhës raportues për shkak të pandemisë botërore të Covid 19, qeveria italiane, ku vepron edhe klienti i vetëm i shoqërisë ka marrë masat për izolimin e qytetarëve dhe pezullimin e aktiviteteve. Parashikohet gjithashtu që masa të tilla të merren edhe nga qeveria Shqiptare, por edhe ato të vendeve Europiane dhe botërore. Si pasojë parashikohet që aktiviteti i shoqërisë të pezullohet dhe reduktohet për një periudhë disa javore gjatë të cilës shoqëria mund të punojë me një kapacitet jo të plotë. Kjo pritet që të sjellë në periudhën pasardhës edhe një rënie të shitjeve dhe si pasojë edhe ulje të rezultatit të shoqërisë, por nuk rrezikon aspak vijimësinë e biznesit.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme që të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.